



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



|  |                               |                               |                               |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar<br>Prilimjen/Prodato<br>Received/Delivery | 31.08.2022                    | 2                             | viti<br>god<br>year           |
| Organ /Njesia<br>Organ /Jedinica<br>Org /Unit                | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SKMST/KK   | 5057/2022                     |                               | 114                           |



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 628/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshin, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.628/2022, të datës 18.07.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë, dhe Inovacionit në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.08.2022 mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.628/2022, të datës 18.07.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET masa disiplinore vërejtje me Nr. Prot: 1475 e datës 06.07.2022 e shqiptuar nga Ministria e Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- III. OBLIGOHET Ministria dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë zbatimin e tij, duke shuar masën disiplinore në pajtim me këtë vendim.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar në pozitën Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit, Ministria e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit më datë 06.07.2022 i ka shqiptuar masën disiplinore vërejtje me Nr. Prot: 1475 me arsyetimin që nuk janë marr masat adekuate nga ana e Inspektoratit të Arsimit, lidhur me administrimit e testit të arritshmërisë.



Ankuesi i pakënaqur me këtë masë, me datë 18.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4167/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 26.07.2022, me numër protokollit 4324/2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ndërsa me datë 05.08.2022 me numër protokollit 4549/2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën A.nr. 628/2022 e datës 18.07.2022, me numër protokollit 4167/2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; vërejte e datës 06.07.2022, me numër protokollit 1475, e shqiptuar nga Ministria e Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; e-09.07.2022; e- maili i datës 05.08.2022; Akt Emërimi i datës 07.10.2016; kërkesa për pushim e datës 27.06.2022; Vendimi i datës 29.03.2022 me numër protokollit 2/281, i Z. v Sekretarit të Përgjithshëm Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Testi i arritshmërisë i vitit 2022; Përgjigje në Ankesë e datës 05.08.2022, me numër protokollit 4559/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e bazuar, SEPSE:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se masa e shqiptuar nga Ministria e Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, si mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse Inspektorati i Arsimit nuk ka asnjë kompetencë të merret me shkelje që ndodhin gjatë procesit të administrimit të testit të arritshmërisë, kështu që inspektorët e arsimit gjatë këtij procesin kanë rol ashtu siç e përcakton ministria sepse nuk ka udhëzim specifik për këtë çështje.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit si dhe shqyrtimit të ligjshmërisë e masës disiplinore vërejte me Nr. Prot: 1475 të datës 06.07.2022 të shqiptuar nga Ministria e Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për ankuesin, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i'u referuar Ligjit Nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, gjegjësisht funksionet e Inspektoratit të Arsimit të përcaktuar me nenin 5, i cili përcakton se: *"Inspektorati i Arsimit kryen këto funksione: 1.1. Funksionin vlerësues – vlerëson cilësinë e shërbimit të institucioneve arsimore. 1.2. Funksionin kontrollues – kontrollon pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve arsimore me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. 1.3. Funksionin këshillues – këshillon drejtuesit dhe punonjësit e institucioneve arsimore. 1.4. Funksionin informues/raportues – informon ministrin, DKA-të dhe institucionet arsimore për gjetjet e inspektimit si dhe i publikon ato në baza vjetore. 1.5. Funksioni mbështetës për promovimin e praktikave të suksesshme të institucioneve arsimore dhe zhvillimin e politikave arsimore. 2. Detyrat për kryerjen e këtyre funksioneve përcaktohen me akt nënligjor"*, si rrjedhojë me nenin 8 të këtij ligjit janë përcaktuar llojet e inspektimeve, si rezultat i kësaj Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr.04/2016 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit në Qendrat e Testimit, ka përcaktuar që komisionin në qendrën e testimit e cakton Ministria e Arsimit me propozim të Divizionit për Vlerësim, Standarde dhe Monitorim, në këtë kuptim Inspektorati i



Arsimit nuk ka kompetencë të mbikëqyrë testin e arritshmërisë, sepse nuk ka ndonjë akt specifik i cili përcakton kompetencat e Inspektoratit të Arsimit në mbarëvajtjen e procesit të testit të arritshmërisë.

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Ministria e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit vërejtje me Nr. Prot: 1475 e datës 06.07.2022, nuk ka arritur në mënyrë të drejtë për përcaktoj se cilat shkelje i ka bërë ankuesi sepse masa disiplinore vërejtje shqiptohet për shkelje të lehta të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, e që konsiderohen: *“4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar”*, ndërsa mbikëqyrja e drejtpërdrejt e ankuesit nuk ka arritur të konstatoj se cilat nga këto shkelje ka bërë ankuesi e që ka qenë obligim sipas dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në rastin konkret mbikëqyrësja e drejtpërdrejt e ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit përveç që nuk ka arritur të konstatoj shkeljen e bërë nga ankuesi, masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, është në kundërshtim me legjislacionin për zyrtarët publikë, respektivisht me nenin 45, nenin 46 paragrafi 4, nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 48 paragrafi 2, nenin 50 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, kështu që pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Na të cekurat si më lartë organi i punësimit gjegjësisht Ministria e Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore janë të obliguar që pas pranimit të këtij vendimi, të ndër marrë veprime juridike që masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit të largohet nga dosja personale e ankuesit në pajtim me këtë vendim.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita

në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.628/2022**

**Avdyl BEKTESHI**

  
**Procesmbajtës**

**Eshref SHABANI**

  
**Kryetar i Kolegjit**



**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankuesit*
- *Ministres së Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së,*

